



Më 13 tetor, 1931, lindi në Mekulas, poeti i “Nënë Shqipëri”.

Në 90 vjetorin e lindjes, DRITËRO AGOLLI:

*-Është Kafka me pak më shumë diell.*

François Nourissier <<Figaro Magasin>>

*-Një autor që meriton fame evropiane.*

Alain Bosquet <<Le Figaro>>

*-Vepra e Dritëro Agollit na intereson edhe për vlerën e saj universale.*

Pierre Gamarra <<Europe>>

-Kjo këngë është për një grua abstrakte, që nuk jeton as në apartament, as në shkallë; as në rrugë, por vrapon atje lart mbi retë, shkel në retë si në një qilim të madh dhe nget pa e ditur se ku do të arrijë dhe se në çfarë krevati do të flerë. Është një grua që duket, por që nuk preket me dorë. Sa të zgjatësh dorën dhe ta prekësh, ajo të kalon si uji i burimit nëpër gishtërinj dhe ikën tatëpjetë. Veçse është shumë e bukur!...

*Kur ikja larg, drejt, drejt teje vija,*

*kur vija afër, ikja shpejt.*

*Për dreq, më trembte largësia*

*Dhe afërsia aq për dreq.*

*As e kuptoja si të desha,  
Një mjegull pus, një turbulli,  
Si një poet që shkruan vjersha  
Dhe ç' del nga vjershat, nuk e di.*

*Dhe ndoshta kjo ish dashuria  
Në shpirtin tim, në sytë e tu:  
Për dreq, na trembte largësia  
Dhe afërsia gjithashtu.*

*Anton Spallj*